



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 755/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Afijete Sada- Glllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e ushtruar nga Anton Shala kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.755/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Anton Shala kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i ushtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: CB101/001,101/ 002, CB102/001,102/ 002, 102/003,102/004,102/005,102/006,102/007,102/008, CB103/003, CB106/004, CB108/001, 108/002,109 003,109 004,109 005, CB111/005, CB115/003, CB116/001, 116/002, CB117/001, 117/003,117/007, CB119/002, 119/010,119/013,119/017,119/020,119/023,119/ 024,119/ 026,119/ 030, CB120/001, 120/002, 120/009,120/ 011, CB125/001, 125/002,125/ 004,125/ 005, 125/006,125/ 007,125/ 008, CB126/001,126/ 003, CB130/003, CB134/002.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.755/2021 Anton Shala kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës, me të cilën pretendon se me datën 28.03.2021 kan dalur rezultatet e rregullta për nr.19ku dhe figurojn zyrtarishtë nga KQZ 5317 vota, ndërsa me datën 01.03.2021 është publikuar formulari me 5410 vota ku jan shtuar edhe 93 votat me kusht. Më tutje pretendon se pas publikimit në faqen zyrtare të KQZ-së në FRP, pretendon se jan 169 vota ose ne tersi duhet të jene 5486 dhe kërkon nga PZAP qe të rinumëroj votat me kusht në këto vendvotime; CB101/001,101/ 002, CB102/001,102/ 002, 102/003, 102/004,102/ 005,102/ 006, 102/007, 102/008, CB103/003, CB106/004, CB108/001, 108/002, 109/003,109/004,109/005, CB111/005, CB115/003, CB116/001,116/ 002, CB117/001, 117/003, 117/007, CB119/002, 119//010,119/013,119/017,119/020,119/023,119/024,119/026,119/030, CB120/001,120/002,120/009,120/ 011, CB125/001, 125/002,125/004, 125/005,125/ 006, 125/007,125/ 008, CB126/001,126/ 003, CB130/003, CB134/002.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit te provave te bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se me datë 05.03.2021 Anton Shala kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës, ka paraqitur apel Anr.755/2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet: CB101/001,101/ 002, CB102/001,102/ 002, 102/003, 102/004,102/ 005,102/ 006, 102/007, 102/008, CB103/003, CB106/004, CB108/001, 108/002, 109/003,109/004,109/005, CB111/005, CB115/003, CB116/001,116/ 002, CB117/001, 117/003,117/007,CB119/002,119//010,119/013,119/017,119/020,119/023,119/024,119/026,119/ 030,B120/001,120/002,120/009,120/ 011, CB125/001, 125/002,125/004, 125/005,125/ 006, 125/007,125/ 008, CB126/001,126/ 003, CB130/003, CB134/002.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.755/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Anton Shala kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Nga rezultati përfundimtar i publikuar nga KQZ-ja, rrjedhe se parashtruesi i apelit ka me tepër se sa që pretendon vet parashtruesi i ankesës.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Anton Shala kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 755/2021 më datën 06.03.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.